

VENDIM
Nr. 373, datë 1.6.2022

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN, NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN,
NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE
NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në kreun I, pas pikës 27 shtohet pika 28, me këtë përmbajtje:

28. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2016/849, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër Republikës Popullore Demokratike të Koresë, të ndryshuar, sipas aneksit 28.”;

b) Pas aneksit 27, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 28, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj